



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 23.05.2023

Nr: 127

Ora: 13:30

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 68, DATË 20.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA ALEANCA DEMOKRISTIANE E SHQIPËRISË"

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 23.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Subjekti zgjedhor "Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë", përfaqësuar nga z. Zef Bushati

OBJEKT:

1. Kundërshtimi i vendimit nr. 86, datë 16.05.2023 të KZAZ-së nr. 76, Përmet për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për këshillin e bashksë Përmet.
2. Rinumërim dhe rivlerësim të votave të vlefshme dhe të pavlefshme në kutitë e votimit për këshillin për të gjitha QV e KZAZ bashkia Përmet, qarku Gjirokastër.



3. Ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatin për këshillin e bashkisë Përmet, duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga procesi i rinumërimit dhe rivlerësimit të votave.

BAZË LIGJORE: Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Subjekti zgjedhor “Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 68 regj., datë 20.05.2023.

Në mbledhjen e datës 23.05.2023, pas relatimit të z. Ilirjan Rusmali u konstatua se kërkesa ankimore nr. 68 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126 dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të Kodit Zgjedhor, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 68, datë 20.05.2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”.
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 24.05.2023, ora 13:30.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Ilirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar